

VENDIM
Nr.629, datë 7.9.2011

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2011, MIRATUAR PËR
MINISTRINË E FINANCAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Financave, në buxhetin e miratuar për vitin 2011, programi “Menaxhimi i të ardhurave tatimore”, t’i shtohet fondi prej 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekësh, për shpenzime korente.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.

3. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha